



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ADMINISTRIMIT TË BRENDSHËM
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË BURIMEVE NJERËZORE, TRAJNIMEVE DHE VLERESIMIT TE PERFORMANCES

SHPLLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË KATEGORINË E LARTË DREJTUESE

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit ,

Bashkia Tiranë – kategoria e pagës: 1-4

PROCEDURA

- nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese të shërbimit civil;
- kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori

KATEGORIA

Kategoria e Lartë Drejtuese

POZICIONI

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit , Bashkia Tiranë – kategoria e pagës: 1-4

Në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut III, VIII të Vendimit nr. 118, datë 05/03/2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nivelit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, ndryshuar me VKM nr. 388, datë 06.05.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 118, datë 05/03/2014”, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Tiranë shpall procedurat për plotësimin e vendit të lirë të kategorisë së lartë drejtuese nëpërmjet procedurës së Pranim në kategorinë e lartë drejtuese në pozicionin:

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit , Bashkia Tiranë – kategoria e pagës: 1-4

Pozicioni më sipër u ofrohet nëpunësve civilë që janë të nivelit të mesëm drejtues dhe që plotësojnë kriteret për të njëjtën kategori dhe kandidate të tjera jashtë shërbimit civil.

Afati për dorëzimin e dokumentave data 26.04.2025.

PERSHKRIMI I POZICIONIT TË PUNËS:

Përcakton objektiva ,menaxhon dhe koordinon punën në tërësi të drejtorisë;

Formulon politika dhe këshillon rreth tyre, ndjek dhe evidenton në bashkëpunim edhe me drejtoritë apo njësitë e tjera organizative përditësimin e akteve ligjore dhe nënligjore në përputhje me veprimtarinë e Bashkisë, në përshtatje me Statutin dhe aktet e tjera nënligjore të saj;

Përcakton objektiva dhe formulon programme në sigurimin e arritjeve të qëllimeve dhe misionit të Drejtorisë Juridike për të mbrojtur statusin juridik të bashkisë, për të verifikuar ligjshmërinë e veprimtarisë së bashkisë dhe parandalimin e shkeljeve në veprimtarinë e saj, siguruar dhe përmirësuar cilësinë ligjore të akteve juridike të nxjerra nga organet e bashkisë;

Planifikon dhe drejton veprimtarinë duke propozuar tek eprori direkt strukturën organizative të drejtorisë si dhe ndryshimet e nevojshme në të, si dhe sigurohet që në këtë strukturë zbatohet një sistem efikas i kontrollit të brendshëm;

Këshillon duke dhënë interpretime ligjore, jep mendime dhe sugjerime, në rastet kur i kërkohet nga eprorët ose strukturat e tjera të Bashkisë;

Shqyrton dhe këshillon ligjshmërinë e akteve apo kontratave në rastet kur i kërkohet nga njësitë e tjera organizative të bashkisë, përpara se ato të miratohen;

Miraton analiza të akteve ligjore dhe nënligjore dhe çështjeve juridike, duke trajtuar problematikat që ato mbartin dhe rrugët e zgjidhjes me pasoje minimizimin e problemeve gjatë zbatimit të tyre;

Drejton punën për klasifikimin e çështjeve gjyqësore sipas rëndësisë së tyre;

Drejton punën për bashkëpunimin me të gjithë strukturat e tjera të Bashkisë në trajtimin dhe përpunimin e korrespondencave administrative, si dhe jep këshillim juridik për problemet që hasen dhe për aktet që do të hartohen;

Kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga Kryetari i Bashkisë apo Sekretari i Përgjithshëm;

Kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga Titullari i Institucionit.

PRANIMI NË KATEGORINË E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë që janë në nivelin e mesëm drejtues dhe plotësojnë kërkesat e posaçme të procedurës.

1. KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA

1.1 KRITERET E PËRGJITHSHME DHE VECANTA QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI PËR KËTË POZICION JANË SI MË POSHTË:

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a. të jetë shtetas shqiptar;
- b. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e
- f. një kundërvajtjeje penale me dashje;

- g. ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar
- h. sipas këtij ligji;
- i. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë e mesme drejtuese (kategoria II-1),
- j. të mos ketë masë disiplinore në fuqi,
- k. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”,

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

-Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal “Master Shkencor” në Shkenca Juridike.

Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

-Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite në nivel drejtues, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e tjera të vetëqeverisjes vendore etj, pjesë e shërbimit civil.

Njohuri dhe aftësi:

- a) Aftësi për të drejtuar dhe menaxhuar veprimet e ndryshme;
- b) Aftësi komunikimi;
- c) Aftësi të drejtimit strategjik;
- ç) Ndërtim i marrëdhënieve ndërpersonale;
- d) Efektivitet;
- dh) Aftësi pune në grup;
- e) Kuptim të gjerë të kompetencave ndërsektoriale;
- ë) Njohuri mbi fenomenet sociale dhe ekonomike;
- f) Besueshmëri;
- g) Vizion;
- gj) Të qenët krijues;
- h) Integritet;
- i) Njohuri për sistemin ligjor evropian.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- ë - aktin e deklaramit të statusit të nepunesit civil
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen me postë apo në sportelet e Sektorit të Informimit dhe Sherbimeve Publike në Bashkinë e Tiranës brenda dates 26.04.2025.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Tiranë, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, ne stendat e informimit të publikut dhe ne faqen zyrtare të Bashkisë Tirane listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë e lartë drejtuese, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë e lartë drejtuese dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Tiranë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail). Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- 1- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”
- 2- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”
- 3- Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”
- 4- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- 5- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- 6- Ligjin nr 7961 dt. 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”
- 7- Ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar
- 8- Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar
- 9- Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- 10- Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- 11- Legjislacionin e prokurimit publik;
- 12- Legjislacioni mbi auditimin;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi maksimal është **100 pikë** dhe përfshin pikët maksimale për secilën nga fazat e mëposhtme:

- a) vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, duke përfshirë (vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore) **10 pikë**;
- b) testim me shkrim, **40 pikë**;
- c) intervistën e strukturuar me gojë, **50 pikë**